

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj: *Te gjitha ushqimet te jene brenda parametrave dhe standarteve te miratuara nga Ministria e Bujqesise dhe ushqimit* si me poshte:

Loti I – Bukë masive R 70

Buka e grurit do te prodhohet me miell rreze 70 %, i stazhionuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh. Mielli duhet te jete i fresket, me ngjyre, ere, shije dhe lageshtire konforme standarteve perkatese te miellit me rreze 70 %. Mielli nuk duhet te kete asnje lloj lende te huaj. Buka duhe te kete forme te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar dhe pa plasje te ndryshme. Vellimi i bukes duhet te jete i mjeftueshem. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet te jete konforme standartit teknik te prodhiit te saj. Korja e bukes – duhet te jete e lemuar, pa djegie, pa shkeputje te saj nga tuli, ngjyra e njellojte, mjalti ne te kuqerremte, ne te gjitha siperfaqen. Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjitha vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 1(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%. Furnizimi i bukes do te behet cdo dite prane magazinave te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Kukes sipas kerkeses. Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster dhe te siguroje mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.

Loti 3 – Qumesht lope me kuti

- Te jete i fresket, i pasterizuar dhe i sterilizuar.
- Te mos kete ne permbajtjen e tij lende konservuese dhe neutralizuese.
- Te plotesoje treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike.
- Ambalazhimi te jete brenda kushteve higjeno-sanitare.
- Ruajtja dhe transportimi me temperature 2 deri ne 8 grade.
- Permbatja e yndyres deri ne 2 %

Pervec asortimenteve te mesiperm Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e kerkeses per mallra te tjere nga lista e mesiperme.

Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e blesit brenda orarit zyrtar te punes 08 00 – 16 00.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Te gjitha artikujt e mesiperm do te furnizohen ne baze te kerkeses se bere nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes. Ofertuesi duhet te siguroje nje furnizim ritmik dhe pa probleme per vete natyren e sherbimit te ketij institucioni. Grafiku dhe levrimi i mallit do te percaktohen ne kontraten midis paleve.

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

1	2	3	4
Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia

Loti 1	Buke		
	Bukë	Kg	9800
Loti 3	Qumesht		
	Qumesht me kuti	Liter	10715

Afatet e lëvrimit:

Nga data e lidhjes se kontrates deri ne date 31.12.2017

